

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202003288/2

Tiranë ___/___/2021

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i menjëherëshëm i kushteve dhe i trajtimit të të dënuarve dhe paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të IEVP-së Kosovë, Lushnjë.*

Drejtuar: **Z. Agim ISMAILI**
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Zoi RRUSHI
Drejtor i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale të IEVP-së

KOSOVË -LUSHNJË

Të nderuar,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 i ligjit nr.81/2020 datë 25.06.2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, kreu një inspektim periodik online në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P) Kosovë Lushnje më datë 06.11.2020, sipas planit të inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita, z. Besnik Deda, dhe znj. Nertila Qafzezi me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Në zbatim të Aktit Normativ nr.7 datë 23.03.2020, të masave të protokollit shëndetësor për parandalimin e pandemisë të shkaktuar nga COVID-19, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, si dhe udhëzimeve të OBSH-së dhe CPT-së, në mbrojtje të shëndetit dhe mirëqënies të personave që vuajnë dënimin në burgje dhe ambiente të tjera të mbyllura, të punonjësve që punojnë në këto institucione (punonjësit e sigurisë, kujdesit shëndetësor dhe personeli tjetër i administratës), si dhe të personave që vizitojnë burgjet apo dhe vendet e ndalimit (mbrojtësit ligjorë, familja, të afërmit e të burgosurve, etj.)¹, inspektimi u krye nëpërmjet videokonferencës, që grupi i monitorimit

¹ http://www.euro.who.int/_data/assets/pdf_file/0019/434026/Preparedness-prevention-and-control-of-COVID-19-in-prisons.pdf?ua=1

zhvilloi me drejtorin, stafin dhe një grup të paraburgosurish dhe të dënuarish të këtij institucioni.

Inspektimet luajnë një rol jetik në sigurimin e një vëzhgimi të vlefshëm të sistemit të burgjeve, një rol i mbështetur edhe në kuadër të praktikave më të mira në monitorimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Në kushtet e situatës së rënduar që po kalon Shqipëria për shkak të sëmundjes infektive *Covid-19*, si dhe në kuadër të respektimit të “*Akteve ligjore për COVID-19*”², duke mbajtur në konsideratë situatën emergjente të krijuar e cila solli pamundësinë e një inspektimi sipas metodologjisë të ndjekur ndër vite, Mekanizmi Kombëtar, si një mënyrë alternative ka vlerësuar të bëjë inspektimet online. Është zgjedhur kjo praktikë e re dhe e domosdoshme për të shmangur rrezikun e infektimit dhe parandalimin e përhapjes së mëtejshme të infeksionit duke pasur në fokusin tonë primar zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe respektimin e akteve ndërkombëtare për parandalimin e torturës, trajtimit të egër, çnjerëzor e poshtërues.

Grupet e punës të Mekanizmit Kombëtar, gjatë inspektimeve online kanë në fokus mbrojtjen dhe sigurinë në ambientet e privimit të lirisë, respektimin e dinjitetit, shëndetit dhe mirëqenies si dhe rehabilitimin e zhvillimin e mëtejshëm të personave që vuajnë dënimin. Gjatë këtyre inspektimeve monitoruese online grupet e inspektimit të Mekanizmit Kombëtar kanë realizuar komunikimin online me drejtuesin e institucionit, shefin e sigurisë, përfaqësues të sektorit të kujdesit shëndetësor, përfaqësues të sektorëve juridikë dhe psiko-socialë, si dhe është kërkuar nga drejtuesit të institucionit që t’u lihet takim online dhe me një grup të dënuar dhe të paraburgosurish.

Gjatë intervistës online grupi inspektues ka ndjekur të njëjtat hapa, si dhe në inspektimet fizike, duke kontrolluar së pari masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të lëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit, si dhe në çdo rast ka kërkuar verifikimin e regjistrave dhe praktikave të mbajtura nga ana e personelit përgjegjës të IEVP-ve kopjet e të cilave janë dërguar më tej në adresën e Avokatit të Popullit.

Grupi inspektimit zhvilloi një seancë me pyetje dhe përgjigje me drejtorin e institucionit z. Rrushi dhe stafin e tij, kryesisht shefat e sektorëve që mbulojnë shërbimet kryesore në institucion, sipas çështjeve që përmban metodologjia e inspektimit në burgje, si dhe një seancë intervistimi online (pa praninë e stafit) me një grup të dënuarish dhe të paraburgosurish, në lidhje me ankesat dhe shqetësimet e tyre.

Mekanizmi Kombëtar, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka të drejtën e detyrimit kushtetues dhe ligjor t’ju parashtrorë gjetjet e këtij inspektimi dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

Shënime të përgjithshme

Videokonferenca u zhvillua në dy faza, fillimisht me drejtorin dhe stafin e këtij institucioni dhe më vete me një grup të dënuarish dhe të paraburgosurish, të cilët kishin shfaqur dëshirën për të komunikuar me grupin e inspektimit të Institucionit të Avokatit të Popullit. Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet penitenciare.

² <https://qbz.gov.al/news/33b00e4f-8efb-4c99-8c45-595cd9b84f1b>

Inspektimi nëpërmjet **videokonferencës online** u zhvillua në vijim të inspektimeve periodike monitoruese e MKPT në IEVP-në, Kosovë, Lushnjë, për vitin 2020. Në bazë të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr.8927/1, datë 27.09.2018, “*Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale*”, i ndryshuar, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale IEVP-së Kosovë, Lushnjë është kategorizuar si **burg i sigurisë së zakonshme**.

Ky institucion ka një kapacitet maksimal prej **182 personash**. Në ditën e **videokonferencës online**, në mjediset e institucionit ishin **129 persona**. Institucioni nuk kishte Sektor të Kujdesit të Veçantë (SKV).

Fillimisht drejtori i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit si dhe arsyen e veçantë të mënyrës së inspektimit, për shkak të situatës së Covid-19, në mënyrë që të mos krijohen shkaqe për përhapjen e saj në një ambient të një rëndësie të veçantë siç janë IEVP-të. Rreziku i shtuar në këto institucione duhet menjanuar maksimalisht. Drejtuesi i këtij institucioni dhe punonjësit e tjerë, me të cilët mori takim online grupi inspektues, u treguan bashkëpunues dhe transparentë gjatë inspektimit të videokonferencës.

Grupi i inspektimit zhvilloi videokonferencën online dhe e regjistroi atë. Pasi mori informacion të dokumentuar nga drejtuesi institucionit të IEVP-së Kosovë - Lushnje, i drejtoi institucionit pyetjet e nevojshme për mbarëvajtjen e punës në institucion si dhe kushtet aktuale të trajtimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve.

Nga komunikimi u konstatua se **nuk kishte mbipopullim**, duke pasur parasysh kapacitetin dhe infrastrukturën e këtij institucioni. Organika e IEVP, Kosovë, Lushnjë ishte e përcaktuar në Urdhërin Nr.58 datë 24.04.2017 të Kryeministrit “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithëshme të Burgjeve dhe institucioneve në varësi të saj*” dhe përbëhej nga 135 punonjës nga të cilët 32 ishin punonjës civilë dhe 103 ishin punonjës të policisë së burgjeve.

Grupi inspektues kërkoi një informacion të përgjithshëm mbi gjendjen e respektimit të të drejtave dhe trajtimit të të dënuarve/paraburgosurve nga ana e stafit dhe punonjësit e policisë të institucionit, si dhe mënyrën e trajtimit dhe adresimit të problematikave pranë organeve eprorë, për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Sipas të dhënave që u morën gjatë **videokonferencës online**, për evidentimin dhe zbatimin e rekomandimeve të bëra më parë nga institucioni i Avokatit të Popullit, rezultoi se:

- Ishte zbatuar rekomandimi për përmirësimin e ambienteve të përbashkëta të jetesës dhe ishin kryer riparimet e nevojshme të tualeteve të përbashkëta në sektorë, riparimin e tubacioneve dhe pajisjeve hidrosanitare të prishura, ndriçuesve dhe lidhjeve elektrike sipas standardeve të sigurimit teknik.
- Ishte zbatuar rekomandimi për pajisjen e plotë të dhomave të të dënuarve dhe të të paraburgosurve me orendi dhe dollapë për vendosjen e rrobave dhe sendeve të tjera personale.
- Ishte zbatuar rekomandimi për plotësimin e nevojave të të dënuarve me medikamentet e nevojshme të IEVP-së, Kosovë, Lushnjë.

- Ishte zbatuar rekomandimi për përmirësimin e shërbimit të sektorit psiko-social në raport me të dënuarit dhe të paraburgosurit të IEVP- së Kosovë Lushnjë.
- Ishte zbatuar rekomandimi për disinfektimin e mjediseve të jashtme të IEVP-së, Kosovë, Lushnjë.
- Ishte zbatuar rekomandimi për pajisjen e IEVP-së, Kosovë, Lushnjë me ambulancë për të garantuar ofrimin e shërbimit në kohë dhe në cilësi për të dënuarit dhe të paraburgosurit dhe për të shoqëruar personat me problem shëndetësorë në spitalet përkatëse të vendit, të pajisur me një ambulancë në IEVP Kosovë – Lushnje.
- Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të dhomës të observim/veçimit.
- Ishte zbatuar rekomandimi për furnizimin me materialet e nevojshme dentare për ofrimin e një shërbimi të plotë dhe të përshtshëm stomatologjik.
- Ishte zbatuar rekomandimi për rikonstruksionin e dhomës së mjekut, farmacistit, dhe infermierisë në IEVP-në, Kosovë, Lushnjë.
- Ishte zbatuar rekomandimi për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të dënuarit dhe të paraburgosurit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive
- Ishte zbatuar rekomandimi për vënien në funksionim të ambienteve për ushtrimin e riteve fetare të fesë së krishterë.
- Ishte zbatuar rekomandimi për plotësimin e pozicionit të farmacistit sipas parashikimeve në organikën e institucionit.
- Ishte zbatuar rekomandimi për mbikëqyrjen e vazhdueshme të veprimtarisë të njësisë tregtare në IEVP-në, Kosovë, Lushnjë për ofrimin e produkteve të ndryshme për të paraburgosurit dhe të dënuarit.
- Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi për krijimin e një ambienti të përshtatshëm biblioteke dhe pasurimin e fondit dhe titujve të librave në IEVP-në, Kosovë, Lushnjë në shërbim të të dënuarve apo të paraburgosurve, pasi bazuar në informacionin e administruar nga ana jonë ishin shtuar vetëm 10 tituj të rinj librash në bibliotekën e këtij institucioni.
- Ishte zbatuar rekomandimi për ofrimin e shërbimit të lavanterisë nga institucioni për larjen veshjeve për të burgosurit.

Ndërkohë që një pjesë e rekomandimeve të mëparëshme të paraqitura nga Avokati i Popullit nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar sipas informacionit të mbledhur gjatë **videokonferencës online** me drejtuesin e institucionit.

Më konkretisht:

- Nuk ishte zbatuar rekomandimi lidhur me rikonstruksionin e godinave të banimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve në IEVP Kosovë/Lushnjë për të siguruar ambiente të përshtatshme dhe dinjitoze.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për furnizimin me ujë të pijshëm dhe 24 orë në ditë në ambientet e Institucionit të IEVP-së, Kosovë, Lushnjë.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për mbulimin me kamera në mënyrë të plotë në korridoret pranë dhomave të veçim/observimit dhe në tërësi për ambientet e tjera të institucionit.

- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për rikonstrukcionin dhe pajisjen me bazë materiale sipas standardeve të dhomave të takimeve të veçanta në IEVP-në, Kosovë, Lushnjë.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë, sipas parashikimeve në organikën e IEVP-së, Kosovë, Lushnjë ose në mënyrë alternative me dy mjekë me kohë të pjesëshme
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për rikonstrukcionin e ambienteve të palestrës dhe plotësimin e saj me bazë materiale në ambientet e Institucionit të IEVP-së, Kosovë, Lushnje.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për të përmirësuar cilësinë dhe larmishmërinë e ushqiminë Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të IEVP-së, Kosovë, Lushnjë në shërbim të të dënuarve dhe të paraburgosurve duke shmangur shpërdorimin e tij në vijim.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për të sjellë në përputhje me standardet dhomat e prindërimit në distancë dhe pajisjen e tyre me bazë materiale për të mundësuar realizimin e takimeve mes të dënuarve dhe fëmijëve të mitur në kuadrin e garantimit të prindërimit në distancë.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për krijimin e një Sektori të Kujdesit të Veçantë në IEVP-në, Kosovë, Lushnjë për të dënuarit dhe të paraburgosurit me probleme shëndetësore.
- Nuk ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave për vendosjen e një tende në ambientet e ajrimi me qëllim që të mund të përdoret normalisht edhe gjatë reshjeve apo ditëve të ngrohta me diell.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për përmirësimin e mjedisit të ajrimit për t'iu përshtatur kushteve klimaterike dhe nevojës për gjelbërim.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për rikonstrukcionin e ambienteve të palestrës dhe plotësimin e saj me bazë materiale në ambientet e Institucionit të IEVP-së, Kosovë, Lushnjë.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për instalimin e një skaneri urë në ambientet e IEVP-së, Kosovë, Lushnjë për të bërë të mundur kontrollin me efikasitet të ushqimeve për të dënuarit dhe të paraburgosurit si dhe të një skaneri për kontrollin e personave që hyjnë në këto ambiente.

Sipas informacionit të marrë në videokonferencën online, drejtuesi i institucionit ka sqaruar se për ambientet dhe kushtet në këtë IEVP i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve realizimin e një investimi sipas standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit në fuqi.

Trajtimi

Grupi i inpektimit në **videokonferencën online** pati për objektiv të punës së tij, edhe mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve, identifikimin e rasteve të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative, apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, si edhe të rasteve të marrjes së masave disiplinore.

Nga informacioni i marrë, nga bisedimi në grupe me të paraburgosurit dhe të dënuarit, grupi inspektimit nuk evidentoi pretendime për tejkalim të forcës fizike nga ana e punonjësve të policisë së burgjeve.

Gjithashtu, të paraburgosurit dhe të dënuarit u përzgjedhën sipas metodologjisë referuar kërkesë/ankesave që kanë paraqitur pranë institucionit përgjegjës dhe Institucionit të Avokatit të Popullit.

Grupi i inspektimit zhvilloi dhe intervista **online** me të burgosurit në rezultoi një numër i madh ankesash, që ishin të lidhura kryesisht me kushtet e përgjithshme të jetesës në institucion si dhe me punën që duhej bërë nga sektori psiko-social dhe ai shëndetësor.

Të dënuarit dhe të paraburgosurit e konsideronin shërbimin e sektorit psiko-social në I.E.V.P, Kosovë Lushnjë, jo në nivelin e duhur. Gjithashtu, sipas të burgosurve, shërbimi mjekësor në këtë institucion nuk ishte në nivelin e kërkuar dhe nuk ofrohej në cilësi.

Të burgosurit, që ishin në videokonferencës online, ngritën si shqetësim dhe problematikën e ilaçeve për efekt shpejtësie duhej t'i siguronin nga familjarët, sikurse edhe për shërbimin stomatologjik i cili nuk funksiononte normalisht si rezultat i mungesës së materialeve dhe medikamenteve.

Problematikë përbënte edhe furnizimi me ujë i të paraburgosurve dhe të dënuarve në institucion, duke qenë se ata furnizoheshin me ujë vetëm 4 orë në ditë, përkatësisht në oraret 06:30-09:30 të mëngjesit dhe 17:00 deri 19:00 të mbrëmjes. Mungesa e ujit nuk u siguronte garantimin e higjienës së përshtatshme personale.

Në IEVP-në, Kosovë, Lushnjë kishte njësi tregtare, për të dënuarit/paraburgosurit për sigurimin e produkteve bazë të domosdoshme personale. Të burgosurit shfaqën pretendime se më parë njësi tregtare kishte patur raste, që ndryshonte çmimet e produkteve. Nga ana e grupit inspektues në komunikim me drejtuesin e institucionit në **videokonferencën online** u pohua se lista e çmimeve ishte e afishuar dhe e aksesueshme dhe shërbimi ofrohej normalisht.

Ankesa nga të dënuarit dhe të paraburgosurit kishte edhe për mungesën e aktiviteteve rekreative në IEVP-në, Kosovë-Lushnjë, të cilët sipas tyre ishin të pakta nisur edhe nga kushtet e pafavorshme të ambienteve.

Masat mbrojtëse.

Në **videokonferencën online** me drejtuesin e institucionit u pohua se sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të IEVP-së, Kosovë-Lushnjë kamerat monitoronin në mënyrë të plotë rreth 60% të mjediseve për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë rreth tre javore. Nga informacioni që morëm shihej si e nevojshme që të shtohej numri i kamerave të vëzhgimit me të paktën 20 copë të tjera në ambientet e brendëshme. U konstatua se kishte nevojë për të paktën 2(dy) kamera në kat, në një kohë që aktualisht kishte vetëm nga 1(një) kamer, që monitoronte këto ambiente.

Mekanizmi Kombëtar (MKPT) vlerëson se vendosja e kamerave për të mbuluar në mënyrë të plotë ambientet e institucionit të IEVP-së, Kosovë, Lushnjë është shumë e nevojshme dhe ndihmon si në kuadrin e garantimit të standarteve të sigurisë, ashtu edhe në

monitorimin në kohë të ofrimit të shërbimeve dhe garantimit të të drejtave për të dënuarit dhe të paraburgosurit.

Observimi, si sektor i rëndësishëm për mbajtjen dhe kujdesin e veçantë të të paraburgosurve të cilët akomodohen rishtazi në IEVP-në, Kosovë, Lushnjë, ishte funksional dhe në momentin e inspektimit në **videokonferencën online** nuk gjendeshin persona në observim. Kishte 1 dhomë observimi, e pajisur me orendi dhe pajisje të nevojshme.

Telefonat punonin në çdo kohë dhe të dënuarit apo të të paraburgosurit e intervistuar në **videokonferencën online**, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me familjarët dhe të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit të brendshëm. Po ashtu, takimet fizike ishin zëvendësuar me takime online në platëformën “Skype”, 4 herë në javë sipas ligjit. Nuk kishte ankesa lidhur me ofrimin e shërbimit telefonik.

Në IEVP-në, Kosovë-Lushnjë, kishte 33 të dënuar që punonin kryesisht si pastrues, sanitarë, shpërndarës ushqimi etj. Të punësuarit ishin të gjithë me kontrata pune dhe çdo muaj mblidhej komisioni i institucionit që parashikonte nevojat për shtimin e numrit të personave që mund të punonin në përputhje me organikën e lejuar të punësimit. Të dënuarit që punonin përfitonin nga ulja e dënimit dhe dhënia e përfitimit monetar, në masë minimale, që depozitohej në numrin e llogarisë të personit sipas kontratës së punës, për të cilën shpërblehen bazuar në dekretin e vitit 1988, ku u njihet e drejta për të përfituar 90 lekë të rinj në muaj.

Punësimi i të paraburgosurve/dënuarve rregullohet sipas neneve 43, 44 të *ligjit nr.81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, ku parashikohet se shpërblimi caktohet në vlerë të drejtë në propocion me sasinë dhe cilësinë e punës së kryer dhe organizimin e saj, që rregullohet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Ashtu si ishte parashikuar dhe nga ligji i mëparshëm, është theksuar dhe në rekomandimet e Avokatit të Popullit se miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave mbetet domosdoshmëri për shpërblimin e drejtë të punës të të dënuarve që kryejnë dënimin në IEVP.

Kushtet materiale.

Grupi i inspektimit verifikoi edhe kushtet materiale, të cilat janë të rëndësishme për respektimin e standardeve normale të jetesës. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale të IEVP-së, Kosovë-Lushnjë **është një institucion i vjetër i ndërtuar në vitin 1976, dhe i amortizuar si godinë**. Infrastruktura e institucionit përbëhet nga dy godina tre katëshe, me 44 dhoma në total.

Është për t'u theksuar se në IEVP-në, Kosovë-Lushnjë, kishte ende nevojë për investime, duke marrë parasysh godinën e amortizuar prej vitesh. Investimi për vitin 2020 ishte 10.000.000 lekë, kryesisht në dyer të reja, riparimin e tualeteve dhe izolimin nga lagështira etj, duke qenë se vetë Ligji Nr.81/2020, datë 25.06.2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve” parashikon se: “Godinat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale projektohen, ndërtohen, si dhe rikonstruktohen në mënyrë që të plotësojnë standardet për garantimin e sigurisë, kushteve të përshtatshme

higjieno-sanitare dhe të mundësojnë zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta të të burgosurve, zbatimin e planit individual të trajtimit të tyre dhe punësimin.

Gjithashtu, në IEVP - Kosovë - Lushnjë është bërë ndarja e të burgosurve në nëpër dhoma konkretisht në dhoma më të mëdha 3-4 të burgosurish dhe në dhoma me hapësirë më të vogëla 1 deri 2 të dënuar.

Theksojmë se Komiteti për Parandalimin e Torturës³ shprehet se norma minimum e hapësirës për person, në institucione të tilla, është 6m² për dhomat për një person dhe 4m² kur në to sistemohen më shumë persona. Në këtë normë nuk mbahet parasysh sipërfaqja e tualetit, që mund të ndodhet brenda dhomës. Gjithashtu, sipas standardit të Komitetit për Parandalimin e Torturës, duhet respektuar dhe distanca ndërmjet mureve të dhomave, që duhet të jetë jo më pak se 2m distancë ndërmjet mureve të dhomës dhe jo më pak se 2.5m distancë nga dyshemeja me tavanin e dhomës.⁴

Në inspektimin **online** drejtuesit e institucionit na pohuan se kuzhina funksiononte në kushte normale pasi pajisjet e gatimit dhe sistemi i aspirimit ishin të standardeve industriale. Në I.E.V.P, Kosovë-Lushnjë punonin 4 (katër) kuzhinierë. Gjithashtu, sipas informacionit, regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menisë së gatimit ishin të sekretuar dhe të protokolluar.

Megjithatë të dënuarit dhe të paraburgosurit në **videokonferencën online** shfaqën ankesa lidhur me cilësinë e ushqimit i cili nuk kishte larmishmëri. U evidentua se një masë e madhe e të burgosurve në IEVP-në, Kosovë-Lushnjë nuk e konsumonin ushqimin e përgatitur në institucion. Mjaft të dënuar kanë pohuar se e merrnin ushqimin nga të afërmit e tyre dhe se nuk e konsumonin ushqimin e institucionit, për shkak të cilësisë. Ky është një problem që duhet trajtuar me seriozitet nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, pasi është i përsëritur si problematikë.

Regjimi dhe aktivitetet.

Gjatë inspektimit në **videokonferencën online** u vu re se zhvilloheshin shumë pak aktivitete të përbashkëta. Kjo ka ardhur dhe si shkak i parandalimit të masave për mospërhapjen e sëmundjes infektive COVID-19. Shumë prej të intervistuarve në videokonferencën online, kërkuan të kenë më shumë aktivitete të përbashkëta edukative ose sportive, si dhe më shumë mjete dhe pajisje sportive, me qëllim shtimin e aktiviteteve edukative e social-kulturore dhe sportive për rehabilitimin dhe ri-integrimin e të burgosurve, kërkohet një bashkëpunim më i mirë me organizatat jofitimprurëse, duke respektuar masat e parashikuara në protokollin shëndetësor për parandalimin e COVID-19 në këtë institucion.

Për sa i përket mbështetjes psiko-sociale që merrnin të burgosurit, gjatë inspektimit me stafin e sektorit të kujdesit psiko-social, u konstatua se aktivitetet që ofroheshin ishin të pakta dhe përbëheshin kryesisht nga diskutimet në grup për tema sociale, këshillime në

³ KPT

⁴ Vendimi Nr.437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, Neni 30 parashikon se: “Në vendosjen e të paraburgosurve apo të të dënuarve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo IEVP-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4m² për çdo person të paraburgosur apo të dënuar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar”.

ambientet e ajrimit, ose në dhomën e improvizuar të takimeve me avokatin kur ajo ishte e lirë, si dhe nga aktivitetet sportive.

Dosjet psiko-sociale u relatua se ishin të plotësuara me përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarit, me vlerësimet e tre mujëoreve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse, të dërguar më anë të emailit zyrtar.

Shërbimi Shëndetësor.

Gjatë **videokonferencës online** në IEVP-në, Kosovë-Lushnjë si dhe nga takimi po online me një grup të burgosurish, u evidentua mungesa e mjekut me kohë të plotë në institucion. Ky është problem thelbësor veçanërisht në kohën e pandemisë.

Personeli i kujdesit mjekësor në IEVP-në, Kosovë-Lushnjë përbëhej nga 1(një) mjek, 1(një) stomatolog, 4(katër) infermierë dhe 1 (një) farmacist. Pra evidentohet mungesa e personelit mjekësor në përputhje me organikën e institucionit. Mjeku aktual punonte me kohë të pjesshme. Ai shkonte çdo ditë në institucion por me kohë të reduktuar, si dhe në rastet kur thirrej nga ndihmës mjeku.

Mekanismi Kombëtar konstaton se mungesa e mjekut me kohë të plotë ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për shmangien e situatave të tilla, duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e stafit pasi mund të ketë raste urgjente të cilat personeli shëndetësor nuk mund t'i përballojë dhe pasojat mund të jenë të rënda.

Në të njëjtën kohë, fakti që mjeku punonte me kohë të pjesshme dhe është i pranishëm në këtë institucion vetëm pjesërisht gjatë ditës, përbën cenim të standardeve të kujdesit shëndetësor. *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet t’u mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”.*

Sipas takimit online të paraburgosurit dhe të dënuareve ishin të pajisur me librezë shëndetësore. Blerja dhe sigurimi i ilaçeve sigurohej blerjet e drejtpërdrejta nga fondi i siguruar nga D.P.Burgjeve. Gjithëashtu dhe një pjesë e blerjeve të medikamenteve të urgjencës siguroheshin nga ky fond. Megjithë rezultoi se sërisht medikamentet ishin të pamjaftueshme për të përmbushur nevojat e të dënuarve.

Theksojmë se institucioni i Avokatit të Popullit në mënyrë të përsëritur ka rekomanduar marrjen e masave për plotësimin e nevojave të të dënuarve me medikamentet e nevojshme dhe në vijim do të kërkohet informacion i vazhdueshëm për hapat e marra në këtë drejtim, si dhe në çështje të tjera që lidhen me përmirësimin e kushteve në këtë institucion.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat*

*dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:
b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.”.*

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëherëshme lidhur rikonstrukcionin e godinave të banimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve në IEVP Kosovë/Lushnjë për të siguruar ambiente të përshtatëshme dhe dinjitoze.
2. Marrjen e masave të menjëherëshme për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e IEVP-së, Kosovë, Lushnjë ose në mënyrë alternative me dy mjekë me kohë të pjesshme.
3. Marrjen e masave të menjëherëshme për furnizimin me ujë të pijshëm 24 orë në ditë në ambientet e Institucionit të IEVP-së, Kosovë, Lushnjë dhe deri në realizimin e plotë të investimit të rritet numri i orareve të furnizimit me ujë në 10 orë në ditë nga 4 që janë aktualisht.
4. Marrjen e masave të menjëherëshme për të realizuar mbulimin me kamera në mënyrë të plotë në korridoret pranë dhomave të veçim/observimit dhe në tërësi për ambientet e tjera të institucionit.
5. Marrjen e masave të menjëherëshme për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të dhomës të observim/veçimit.
6. Marrjen e masave për rikonstrukcionin dhe pajisjen me bazë materiale sipas standardeve të dhomave të takimeve të veçanta në IEVP-në, Kosovë, Lushnjë.
7. Marrjen e masave të menjëherëshme për të sjellë në përputhje me standardet dhomat e prindërimit me distancë dhe pajisjen e tyre me bazë materiale për të mundësuar realizimin e takimeve mes të dënuarve dhe fëmijëve të mitur të tyre në kuadrin e garantimit të prindërimit në distancë.
8. Marrjen e masave të menjëherëshme për përmirësimin e higjienës në dhomat e banimit të të paraburgosurve/dënuarve, dhe në ambientet e përbashkëta në institucion.
9. Marrjen e masave të menjëherëshme për krijimin dhe vënien në funksion të dhomave të këshillimit psiko-social në godinat e IEVP-së, Kosovë, Lushnjë.
10. Marrjen e masave të menjëherëshme për të garantuar akomodimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve në mjedise të përshtatshme banimi duke respektuar normat në minimum të hapësirës për person, në institucione të tilla, që janë 6m² për dhomat për një person dhe 4m² për person, kur në to sistemohen më shumë banorë.

Për sa kohë institucioni nuk ka shfrytëzim në kapacitetet maksimale të paktën të garantohet akomodimi i të dënuarve në hapësira sipas standardeve.

11. Marrjen e masave urgjente për të përmirësuar cilësinë dhe larmishmërinë e ushqimit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale IEVP, Kosovë, Lushnjë në shërbim të të dënuarve dhe të paraburgosurve duke shmangur shpërdorimin e tij në vijim.
12. Marrjen e masave për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të dënuarit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive, në bashkëpunim dhe me organizatat jofitimprurëse duke respektuar masat e parashikuara në protokollin shëndetësor për parandalimin e COVID-19 në këtë institucion.
13. Marrjen e masave për krijimin e metodave alternative për të ardhur në ndihmë të burgosurve gjatë kësaj periudhe.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

ERMONELA XHAFA